

FLEX-PRIMER

Prajmer (astar) akrilik me cilësi të lartë i tretshëm në ujë

Përshkrimi

Emulsion polimeri shumë depërtues. Stabilizon nënshtresat poroze dhe garanton ngjitjen e duhur të bojërave të ujit, të kolës së pllakave, llaçit elastik, veshjeve elastomerike lyerëse, të suvasë akrilike etj.

Duke depërtuar brenda poreve të nënshtresës, ai vepron si një shtresë ngjitëse midis nënshtresës dhe bojës, kolës, llaçit, veshjes etj. që do të aplikohet.

Fushat e përdorimit

E përdorur në kombinim me bojën elastike të padepërtueshme nga uji FLEXCOAT, ai formon një sistem ideal për hidroizolim in e mureve.

FLEX-PRIMER është një prajmer (astar) i gatshëm për përdorim, i përshtatshëm për të garantuar ngjitjen e bojërave të ujit dhe suvasë akrilike mbi shtresa porozre të përbëra nga betoni, llaçi, suvaja, pllakat e gipsit, pllakat e zdrukthit etj.

Ai stabilizon suvanë e dobët ose që shkërmoqet etj.

Ai përdoret gjithashtu për stabilizimin dhe reduktimin e absorbimit të ujit të sipërfaqeve, si pllakat e gipsit ose pllakat e zdrukthit, mbi të cilat do të aplikohen në vijim kolat e pllakave AQUAMAT-ELASTIC (llaç izolues lyerës elastik me 2 përbërës) ose Isomat® SL 17 (material lyerës elastomerik i lëngshëm për hidroizolim in nën pllaka).

Është i përshtatshëm për përdorime në ambiente të jashtme dhe të brendshme.

Të dhënat teknike

Trajta:	emulsion
Ngjyra:	e bardhë
Densiteti:	1,00 kg/litër

Udhëzimet e përdorimit

1. Nënshtresa

Sipërfaqja që do të lyhet duhet të jetë e thatë dhe pa pluhur, graso, papastërti etj.

2. Përdorimi

FLEX-PRIMER trazohet plotësisht dhe aplikohet në mënyrë uniforme mbi shtresë me anë të furçës, rulit ose spërkatjes, përpara lyerjes.

Konsumi

100-200 g/m², në varësi të aftësisë thithëse të sipërfaqes.

Ambalazhimi

FLEX-PRIMER ofrohet në bidonë plastikë 1 kg, 5 kg dhe 20 kg.

Magazinimi

Afati i ruajtjes për përdorim, në bidonë të izoluar dhe në ambiente pa ngrica, është minimumi 24 muaj.

Shënime

- Temperatura gjatë aplikimit duhet të jetë të paktën +5°C.

FLEX-PRIMER



Përbërësit organikë të avullueshëm (VOC)

Sipas Direktivës 2004/42/KE (Shtojca II, tabela A), përmbajtja maksimale e lejuar e VOC-së për produktin e nënkategorisë "h", lloji WB është 30g/l (2010) për produktin e gatshëm për përdorim.

Produkti i gatshëm për përdorim FLEX-PRIMER përmban maksimumi <30 g/l VOC.

ISOMAT S.A.

BUILDING CHEMICALS AND MORTARS

ZYRAT QENDRORE – FABRIKA:

17th km Thessaloniki - Ag. Athanasios Road,
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag. Athanasios, Greece,
Tel.: +30 2310 576 000, Faks: +30 2310 722 475

www.isomat.eu e-mail: info@isomat.eu

Informacioni teknik dhe udhëzimet e dhëna në këtë fletë të dhënash bazohen në njohurinë dhe në përvojën e Departamentit të Kërkimit dhe të Zhvillimit të kompanisë sonë dhe në rezultatet e dala nga përdorimet afatgjata të produktit në praktikë. Rekomandimet dhe sugjerimet që i referohen përdorimit të produktit jepen pa garanci, meqenëse kushtet e terreneve gjatë përdorimeve të tij janë përtej mundësisë së kontrollit të kompanisë sonë. Si rrjedhojë, përdoruesi është përgjegjës për të konfirmuar se produkti i zgjedhur është i përshtatshëm për përdorimin e parashikuar. Botimi aktual i kësaj flete të dhënash teknike anulon automatikisht çdo botim të kaluar që lidhet me të njëjtin produkt.

